



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 14.12.2023)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 10:55.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>3. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Emona Muçi</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Gentiana Muçaj</i>  | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>8. Markelian Koça</i>  | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami; Gjithashtu nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Irena Plaku.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.*

*3. Staf administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>1</sup>

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë, në rendin e ditës datë 14.12.2023, ora 10:30, lidhet me caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme. Mbledhja drejtohet nga Zëvendëskryetari zoti Rusi, pasi Kryetarja e Këshillit është në një angazhim institucional. Në fjalën e tij z. Rusi uron gjithashtu edhe tre anëtarët e ardhur rishtazi në Këshill.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e relacionit të përgatitur për caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Deri më datë 23.10.2023, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme: Bëhet fjalë për 1 çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet shortit elektronik, sipas tabelës në relacion).

Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për të shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme që ka për objekt: “Dërgimin e çështjes në gjyq”, pra shqyrtimi i çështjes në seancë paraprake. I pandehuri është shtetasi {...}. Gjyqtarja e caktuar më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor-ja me vendimin nr. 638, datë 24.10.2023, znj. {...}, ka paraqitur një raport për barrë lindje, kështu që ajo ka qenë në pamundësi objektive për të shqyrtuar kërkesën në seancë paraprake si gjyqtare e seancës paraprake. Dosja e mësipërme është ndarë nga dosja me të pandehur {...}. Për këtë çështje që është objekt trajtimi në mbledhjen e sotme kanë pengesë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} pasi kanë kryer veprime në fazën e hetimeve paraprake; Trupi

---

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

grykues i përbërë nga gryqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë një vendim penal në ngarkim të të pandehurve në një procedim të lidhur shtetasi {...} etj.

Trupi grykues i përbërë nga gryqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. {...}, datë 14.12.2022 në ngarkim të pandehurit në procedim të lidhur {...} Gryqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin për dosjen tjetër të ndarë nr. {...} regj, datë 05.12.2022 në ngarkim të pandehurit në procedim të lidhur {...} etj; Gryqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë në grykim të pandehurin në procedim të lidhur {...}. Gryqtari {...} ka vendosur dërgim për grykim në themel të dosjes penale në ngarkim të të pandehurve {...} etj., dhe Këshilli me vendimin nr. 638/2023 ka vendosur plotësimin e trupit grykues për atë çështje penale me gryqtarët {...} dhe {...}.

Ky parashtrim u bë për të treguar numrin e gryqtarëve të cilët kanë formuar trupat grykues, kanë grykuar çështjen në një procedim të lidhur apo janë në proces grykimi për procedime të tjera të ndara nga ai procedim për të cilin kërkohet sot caktimi i një gryqtari.

Për nevojat si më lart të Grykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gryqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gryqtarit për grykimin e një çështje gryqësore të veçantë, në një grykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

1. Grykata nga duhet të përzgjidhen gryqtarët që do të caktohen për grykimin e 1 (një) çështjeje gryqësore të veçantë, të jenë grykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gryqtarët për grykimin e 1 (një) çështjeje gryqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gryqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gryqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Numri i gryqtarëve që duhet të caktohen për grykimin e 1 (një) çështjeje gryqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gryqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër.

Bashkëlidhur relacionit është edhe lista e gryqtarëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t’iu nënshtruar shortit.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr.3349), gjyqtarja Matilda Llangozi.

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**